



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

GJIROKASTËR

BORDI I ADMINISTRIMIT

Gjirokastrë, më 10.01.2020

V E N D I M

NR. 02, DATË 10.01.2020

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR POZICIONIN E PUNËS "SPECIALIST
INXHINIER/ARKITEKT".**

Në mbështetje të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015, "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 49, pika f, si dhe bazuar në shkresën e Administratorit të Universitetit me nr. 35 Prot., datë 09.01.2020, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 10.01.2020,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret për pozicionin e punës "Specialist Inxhinier/Arkitekt".
- A. Të interesuarit për pozicionin e mësipërm duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - Të ketë kryer arsimin e lartë në degën arkitekturë;
 - Të ketë përvojë pune në grup;
 - Të ketë aftësi të mira komunikuese;
 - Të jetë shtetas shqiptar;
 - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
 - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
 - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
 - Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore, që nuk është shuar sipas ligjit;

B. Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë me shkrim për të aplikuar ;
- Diplomën e shkollës së lartë ;
- Curriculum vitae (CV);
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Raport mjeko – ligjor;
- Librezë pune nëse posedon;
- Dëshmi penaliteti ose aplikim për marrjen e saj.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dr. Merita Isaraj